



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Për:	Menaxherin e Prokurimit: MI "SALLAHU" SHPK "RSM COMPANY" SHPK	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 282/19 296/19
Prej:	Hysni Muhadri – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 282/19 të parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik dhe ankesën me Nr. 296/19 të parashtruar nga OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë.		
Datë	26.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 05.06.2019, me nr. 282/19 të parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik, ankesën e datës: 10.06.2019, me nr. 296/19 të parashtruar nga OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MI
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - "SALLAHU" SHPK & "RSM COMPANY" SHPK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik dhe OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

	12.06.2019	26.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 05.06.2019, OE **"SALLAHU" SHPK** – Kaçanik, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të aktivitetit të prokurimit: **"Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m"**, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

Me datën: 10.06.2019, OE **"RSM COMPANY" SHPK** - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të aktivitetit të prokurimit: **"Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m"**, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

Nuk janë përsëritur ankesat.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

*Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"SALLAHU" SHPK** – Kaçanik dhe OE **"RSM COMPANY" SHPK** – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m"**, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).*

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "SALLAHU" SHPK – Kaçanik, janë:

Neni 6 – Ekonomicitet dhe Efikasiteti;

Neni 54 – Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar;

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

Neni 60 – Kriteri për Dhënien e Kontratës;

Neni 68– Gjendja ekonomike dhe Financiare;

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Dorëzimi i ofertës është i bazuar në baze të dosjes së tenderit të datës 20.03.2019, ku nga faqe 10 deri 16 (Seksioni II. Fleta c të dhënave të tenderit FTD), janë të dhënat e tenderit të cilat duhet plotësuar.

Gjatë vlerësimit të ofertave komisioni i vlerësimit nga Ministria e infrastrukturës ka shkelur rregullat e LPP-së dhe ka dalë në kundërshtim me fletën e të dhënave të tenderit dhe kriteret e paraqitura në të.

Duke e pasur parasysh se kriteret e kërkuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit FTD nuk janë marrë për bazë gjatë procesit të vlerësimit, me çrastë është shpallur i suksesshëm grupi i Operatoreve Ekonomike të cilët nuk i plotësojnë as edhe kriteret bazë të kërkuara sipas FTD-së.

Ministria e Infrastrukturës duke e shpallur fitues grupin e Operatoreve Ekonomike "Erst Bau" Shpk & "Alba Konstruktion" Shpk njëkohësisht duke na diskriminuar ne si kompani ka shkelur LPP-në dhe aktet tjera të LPP-së.

Me rastin e eliminimit nga procedura e tenderimit zyra e prokurimit na ka njoftuar më datën 21.05.2019, duke na e dërguar Letrën Standarde për tenderuesin e Pasuksesshëm, në të cilin thuhet: Tenderi juaj nuk qe tenderi më i mirë në të ulët.

Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve është shkelur neni 7, 59 dhe 60 pasi që grupi i Operatoreve Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk i plotësojnë kriteret e kërkuar si në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit: TENDERI I PËRGJEGJESHËM ME ÇMIMIN MË TË ULËT, ku vet Ministria e Infrastrukturës i ka paraparë për këtë projekt.

Në veçanti komisioni i vlerësimit ka bërë shkeljen e nenit 60, duke rekomanduar për kontratë grupin e OE

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik dhe OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

"Erst Bau" Shpk & "Alba Konstruktion" Shpk të cilët nuk i plotësojnë as edhe kriteret bazë për dhënie të kontratës siç është TENDERI I PËRGJEGJESHËM ME ÇMIMIM MË TË ULËT.

Ky vlerësim i tenderit mundë të cilësohet joprofesional nga komisioni i vlerësimit i caktuar nga Ministria e Infrastrukturës.

Komisioni i emëruar për vlerësim ka bërë shkelje duke mos e respektuar LPP-në gjatë vlerësimit të ofertave. Gjatë qasjes në dokumente kemi arritur të identifikojmë një numër të madh të kriterëve të pa plotësuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë të cilat mundë ti gjeni në elaborim më poshtë.

Më datën 24.05.2019 kemi ushtruar kërkesë për rishqyrtim, ku Autoriteti Kontraktues më datën 24.05.2019 me vendimin numër 5600 e pezulloi aktivitetin e prokurimit, ndërsa më datën 27.05.2019 me vendimin numër 5643 na e refuzoi kërkesën për rishqyrtim.

Komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të tenderëve ka shkelur LPP dhe aktet e tjera nënligjore duke rekomanduar për kontratë grupin e Operatorëve Ekonomikë si të përgjegjshëm, ku gjatë qasjes në dokumente më datën 22.05.2019 ora 13:00 kemi siguruar dëshmi se grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë nuk i plotësojnë kriteret sipas, Seksioni II. Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD), pasi që ka mungesë të dokumentacionit:

"Erst Bau" Shpk & "Alba Konstruktion" Shpk

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. Sipas FDT-së pika 8.1 & 8.2 është kërkuar (OE duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjatë 3 viteve të fundit ka qenë në vlerë së bashku në tri vitet, prej jo me pake se 5,000,000.00 €, Të prezantohen deklaratat vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit). Grupi i OE nuk ka arritur të dëshmojë se qarkullimi i grupit të OE për tri vitet e fundit është 5,000,000.00 €, pasi që në deklaratat tatimore të anëtarit të konzorciumit "Erst Bau" Shpk qarkullimi për tri vite është 1,305,478.13 €, ndërsa anëtari tjetër i konzorciumit "Alba Konstruktion" Shpk ka prezantuar vërtetim nga Drejtoria e përgjithshme e tatimeve si dhe ka bashkangjitur raportin e auditimit të kompanisë, për të cilat është kërkuar deklarata vjetore tatimore e Administratës Tatimore e jo vërtetim dhe raporti i auditimit.

Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Grupi i konzorciumit "Erst Bau" Shpk & "Alba Konstruktion" Shpk si menaxher të projektit kanë paraqitur inxhinierin Genc Gjafa për të cilin nuk kanë paraqitur nostrifikimin e diplomës pasi që i njëjti ka përfunduar studimet në Tiranë dhe sipas ligjit në Ministrinë e Arsimit në Kosovë, ç'do diplomë e ardhur nga jashtë për të qenë e valide në Kosovë duhet ti nënshtrohet procesit të nostrifikimit.
2. Grupi i konzorciumit "Erst Bau" Shpk & "Alba Konstruktion" Shpk si inxhinier të Hidroteknikës kanë paraqitur inxhinierin Merkur Kamo për të cilin nuk kanë paraqitur nostrifikimin e diplomës pasi që i

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik dhe OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

njëjti ka përfunduar studimet në Tiranë dhe sipas ligjit në Ministrinë e Arsimit në Kosovë, ç'do diplomë e ardhur nga jashtë për të qenë e valide në Kosovë duhet ti nënshtrohet procesit të nostrifikimit.

3. Sipas pikës 6 të FDT-se është kërkuar (Lista e kontratave të realizuara përfunduar ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 5,000,000.00 euro. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve, Dëshmia 6. Procesverbalet e pranimi përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare). Grupi i OE nuk ka paraqitur Procesverbalet e pranimi përfundimtarë por ka paraqitur Referencat, të cilat sipas FDT-së është kërkuar procesverbali i pranimi përfundimtar. kërkuar procesverbali i pranimi përfundimtar.
4. Sipas pikës 7 të FDT-se është kërkuar (Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje te tenderit, Dëshmia 7. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmojnë me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.) Anëtar i grupit të OE "Erst Bau" Shpk ka prezantuar kontrata mbi huazimin e mjeteve të punës me kompanitë: "Famis Co", "Eurofamis", "I. Seferi", "Kolgeci NP", "K.Sopaj", "Alton", "Buli NTSH" dhe mes personave fizik: "Ibrahimi", marrëveshje të cilat nuk janë të noterizuara nga noteri siç është kërkuar në FDT-në pika 7. Si dhe për disa mjete të cilat regjistrohen grupi i OE ka prezantuar faktura jo librezat e regjistrimit siç është kërkuar.
5. Sipas pikës 8 të FDT-se është kërkuar (OE duhet të jete i licencuar për prodhimin e bazës së asfaltit, Dëshmia 8, 9, 10 - Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale, Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet të jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit). Grupi i OE ka prezantuar kontratën mbi furnizimin me asfalt në mes të "Erst Bau" Shpk dhe "I.Scferi" Shpk e cila nuk është e noterizuar nga noteri siç është kërkuar në FDT por kanë ofruar kontratën mbi furnizim Vërtetim i Kopjes nga Origjinali, si dhe kanë paraqitur Lejen për Aktivitete të Veçanta me numër 473/KPMM/2016 me numër të protokollit 1520 të datës:15.04.2016 e cila kohëzgjatjen e ka deri më 13.04.2019 e cila është me aftë të skaduar.
6. Sipas pikës 9 të FDT-se është kërkuar (OE duhet të jete i licencuar për prodhimin e bazës së asfaltit, Dëshmia 8, 9, 10 - Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale, nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE të licencuar. Bashkangjitur duhet të jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar ne mes të qiramarrësi dhe qiradhënësit). Grupi i OE ka prezantuar kontratën mbi furnizimin me guri në mes te "Erst Bau" Shpk dhe "Famis co-Hc" Sha e cila nuk është e noterizuar nga noteri siç është kërkuar në FDT por kanë ofruar kontratën mbi furnizim Vërtetim i Kopjes nga Origjinali.
7. Sipas pikës 10 të FDT-së është kërkuar (OE duhet të jete i licencuar për prodhimin e bazës së asfaltit, Dëshmia 8, 9, 10 - Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale, Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon Licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE të Licencuar. Bashkangjitur duhet të jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar ne mes

te qiramarrësi dhe qiradhënësit). Grupi i OE ka prezantuar kontratën mbi furnizimin me beton në mes të "Erst Bau" Shpk dhe "Famis co- Hc" ShA e cila nuk është e noterizuar nga noteri siç është kërkuar në FDT por kanë ofruar kontratën mbi furnizim Vërtetim i Kopjes nga Origjinali.

8. Sipas pikës 11 të FDT-së është kërkuar (OE duhet të ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshirë përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do të realizohet, Dëshmia 11. Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe vulosur nga kompania). Grupi i OE nuk ka prezantuar planin e menaxhimit të trafikut siç është kërkuar të nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe të vulosur nga kompania.

Duke pasur parasysh të gjitha shkeljet e bëra nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Infrastrukturës gjatë vlerësimit të aktivitetit të prokurimit kërkojmë që Aktiviteti i prokurimit të kthehet në Ri-vlerësim.

Të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues "SALLAHU" SHPK – Kaçanik, janë të shënuar në ankesë:

Operatori Ekonomik Ankues "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues **COMPANY" SHPK – Prishtinë, janë:**

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

Neni 60 – Kriteri për Dhënien e Kontratës;

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Neni 59 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve;

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të këtij neni, duke vlerësuar gabimisht dhe në mos përputhje me Ligjin e Prokurimit, pasi që konzorciumi i shpallur fitues "Erst Bau & Alba Konstruktion", nuk plotëson të gjitha kërkesat e vendosura në Dosjen e tenderit.

Po ashtu AK-ja bën shkelje të këtij neni duke eliminuar kompaninë "RSM Company" shpk, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat DT.

Neni 60 – Kriteri për Dhënie n e Kontratës;

Autoriteti Kontraktues bën shkelje të paragrafit 1.1 të këtij neni, duke shpallur fitues konzorciumin i cili nuk ka dorëzuar oferte të përgjegjshme, dhe është dashur të eliminohet, dhe duke dëmtuar kompaninë "RSM Company" shpk, e cila edhe pse ka dorëzuar oferte të përgjegjshme, në pajtueshmëri të plote me kërkesat e

dosjes se tenderit, është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe /ose Profesionale;

Në Dosje te tenderit tek lista e makinerive, pika 16 është kërkuar “Cilindra me rrota të kombinuara (gome,hekur) 7-8 tone”, në kemi paraqitur 2 kontratat e shitblerjes me “Drini Company”, për 2 cilindra. me kapacitet 7 ton te tipit Hamm 3307 HT, të cilët janë Cilindra gome, hekur në përputhje të plote me kërkesat e DT-se, si nga modeli dhe ashtu edhe nga pesha e kërkuar, dhe mund të verifikohen në çdo kohe nga ana e Autoritetit Kontraktues. - **Prove Kontratat e shitblerjes për cilindrata ne fjale.**

Kurse Autoriteti Kontraktues nuk na është përgjigjur fare për këtë pike të kërkesës për rishqyrtim që kemi dërguar.

Mungesat e JV “Erst Bau & Alba Konstruktion”.

Tek Lista e Makinerive pika 16 është kërkuar: Cilindra me rrota te kombinuara (gome,hekur) 7-8 ton” sasia e kërkuar 2 cope, kurse konzorciumi i shpallur fitues ka paraqitur Cilindrin Hamm DV90VO, i cili është me peshe 9.4 tone, pra pesha e tij nuk është sipas kërkesave të DT-së. – Provë DUD.

Tek Lista e Makinerive pika 17 është kërkuar; Cilindër me rrota hekuri me vibrim 12 ton, sasia e kërkuar 2 cope, kurse konzorciumi i shpallur fitues ka paraqitur 2 cilindra që nuk janë në përputhje me kërkesat. Cilindër Boëil TB (Huazim nga Kolgeci NP) me peshë 10.8 ton që nuk është në përputhje me kërkesën pasi që është me peshe më të vogël sesa është kërkuar.

Po ashtu edhe cilindri tjetër i paraqitur “Dynapack (Huazim nga Kolgeci NP) me peshe 6.7 ton, nuk është në përputhje me kërkesën sepse është me peshe më të vogël sesa është kërkuar. – Provë DUD-at.

Tek Lista e Makinerive pika 18 ehte kërkuar: Cilindër me rrota hekuri me vibrim 3 ton, kurse konzorciumi i shpallur fitues ka paraqitur 3 cilindra: Hamm DV2 (Huazim nga Kolgeci NP) me peshe 2.6 ton, Hamm HDI OK (Huazim nga Eurofamis) me peshe 2.5 ton dhe Bomag 100AD3 (Huazim nga Eurofamis) me peshe 2.4 ton. Pra asnjëri nga këta cilindra nuk kane peshën e kërkuar prej 3 ton, ashtu siç është kërkuar në DT. – Prove Dudat.

Tek Lista e Makinerive pika 18 është kërkuar: Cisterne (tanket) i ujit, sasia 3 cope, kurse konzorciumi i shpallur fitues, ka paraqitur një fature për cisterne “Majevica 14026” dhe jo Librezën, pasi qe autocisternat janë makineri qe qarkullojnë në komunikacion dhe patjetër duhet te regjistrohen, pra edhe kjo makine e paraqitur nuk është në përputhje me kërkesat e DT-se. - Prove Fatura.

Kurse Autoriteti Kontraktues, ne lidhje me pretendimet tona për këto parregullsi tek makineritë i ka quajtur devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale, ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera te parashtruara në Dosje të tenderit dhe njoftimin për kontrate.

Kurse neve si kompani ne tenderin me titull: “Zgjerimi i rrugës Nacionale N2, segmenti Hyrja në qytetin e

Prishtinës (Veterrik),” me nr. Prokurimi: MI 19 016 511, na kane eliminuar me arsyetimin se Automikseseret e paraqitur nuk kane qene 8 m3 por 6m3. Kjo tregon qe Ministria e Infrastrukturës po përdorë standarde te dyfishta dhe seleksionuese gjate vlerësimit për kompani të ndryshme, pasi qe për neve nuk kane qene devijime të vogla por arsye për eliminim.

Në FDT, pika 9.1 dhe 9.2, nënëpika 8 është kërkuar: “OE duhet te jete i licencuar për prodhimin e bazës se asfaltit” dhe si dëshmi të paraqitet: “Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale”, kurse Konzorciumi i shpallur fitues ka paraqitur Marrëveshjen për furnizim me Asfalt me kompaninë I-Seferi, për të cilin është paraqitur Licenca e skaduar e KPMM-se dhe dokumentet e kësaj kompanie që ka aplikuar për Licencim, kurse ne DT është kërkuar decidivisht te paraqitet Licenca Valide, dhe jo dokumente tjera jo te barazvlefshme me Licence. - **Prove Licenca e skaduar.**

Autoriteti Kontraktues për këtë pretendim tonin ka thënë: “OE i rekomanduar për kontrate ka dëshmuar me një dokument të lëshuar nga KPMM, ku ceket se OE i ka të gjitha dokumentet dhe se ky dokument mund të përdoret për tender”, që është në kundërshtim me vete kriteret e vendosura nga ana e tyre pasi qe kërkesa është që të paraqitet kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale, dhe asnjë dokument nuk mbulon kërkesën në dosjen e tenderit.

Në Dosje te tenderit, Pika 9.1 & 9.2, nenpika 1 është kërkuar: 1. Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmi e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve)”

Kurse konzorciumi i shpallur fitues ka paraqitur si Menaxher te Projektit, z. Genc Xhafa - Inxhinier për Ndërtime Civile-Industriale, drejtim i cili nuk përfshinë ndërtimin e rrugëve, pra jo ne përputhje me kërkesat e FDT. Edhe për këtë pretendim tonin, AK-ja nuk na ka kthyer përgjigje ne Vendimin e tyre.

Për të njëjtën arsye është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit “Zgjerimi i rrugës Nacionale N2 segmenti Hyrja në Qytetin e Prishtinës (Veterrik) ME NR. PROKURIMI: MI-19-016-511. JV “JOOS KRASNIQI & PEVLAKU”, edhe këtu shihet përdorimi i standarde të dyfishtë gjatë vlerësimit për kompani të ndryshme – Provë Letra standarde për eliminimin e “JOOS KRASNIQI & PEVLAKU”.

Të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues “RSM COMPANY” SHPK – Prishtinë, janë të shënuar në ankesë:

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....	25.03. 2019
Lloji i procedurës së aplikuar.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....	Kontratë publike punë
Vlera e parashikuar e kontratës.....	4,300.000,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52).....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	03.05.2019
Data e hapjes së ofertave.....	03.05.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	20.05.2019
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së.....	20.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim "SALLAHU" SHPK:	24.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "SALLAHU" SHPK :	27.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim "RSM COMPANY" SHPK:	27.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim "RSM COMPANY" SHPK :	30.05.2019

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
a)Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	a)Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit – Aneksi 2
b)Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e	b)Vërtetim nga Administrata Tatimore.
	c)Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal kopje.
	d)Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal kopje
	Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik dhe OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

<p>fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.</p> <p>c)Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.</p> <p>d)Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.</p>	<p><i>kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.</i></p>
<p>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>a). Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës).</p> <p>b) Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore).</p> <p>c) Certifikata e numrit fiskal (vetëm për kompanitë vendore).</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të biznesit.</i> <i>2. Kopja e Certifikatës e TVSH-së .</i> <i>3. Kopja e Certifikatës me numër fiskal .</i>
<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>1. OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjatë 3 viteve të fundit ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 5,000,000.00.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit.</i>

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

2. Udhëheqës i punishtes Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, infrastrukturë rrugore me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit të rrugëve; minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.

3. Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik - tri vite përvojë pune pas diplomimit , si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.

4. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjeodezisë me pesë vite përvojë pune pas diplomimit . Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

5. Një (1) Inxhinier i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar i komunikacionit me tri vite përvojë pune pas diplomimit në lëmin e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

6. Lista e kontratave të realizuara përfunduar në lëmin e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 5,000,000.00 euro. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1. CV e inxhinierit, diploma e noterizuar,, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Menaxheri duhet të ofroj një deklaratë që nuk është i angazhuar në projekt të MIT (deklaratë e nënshkruar).

Dëshmia 2. CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Dëshmia 3. CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Dëshmia 4. CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Dëshmia 5. CV, kontrata e punës me punëdhënësin (kopje e noterizuar), diploma (e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Dëshmia 6. Procesverbalet e pranimi përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëmin e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare.

Dëshmia 7. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve.

lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve.	<i>Marrëveshja duhet të jetë në emër të projektit me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit. Nëse OE aplikon për dy pjesë (lot) atëherë duhet të ofrohen pajisje për dy pjesët sipas listës tek Aneksi 1.</i>
7. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 1 për pjesën 1 dhe pjesën 2.	<i>Dëshmitë 8, 9, 10 - Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE të licencuar. Bashkangjitur duhet të jetë Licencat e OE. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.</i>
8. OE duhet të jetë i licencuar për prodhimin e bazës së asfaltit.	<i>Dëshmia 11. Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe vulosur nga kompania.</i>
9. OE duhet të jetë i licencuar si gurëthyes zhavorr.	<i>Dëshmia 12. Planit dinamik i nënshkruar dhe vulosur nga kompania.</i>
10. OE duhet të jetë i licencuar për prodhimin e bazës së betonit.	
11. OE duhet të ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshirë përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do të realizohet.	
12. Kërkesa – OE duhet të ofroj plani dinamik për realizimin e projektit.	

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi	Çmimi me TVSH	Vërejtje
1.	"PE-VLA-KU SHPK & JOOS KRASNIQI BAZE"	Prishtinë	3,460.593.37€	4,083.500.18€	JO
2.	"ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION"	Suharekë	3,211.468.81€	3,789.533.30€	JO
3.	"LIKA TRADE" SHPK	Deçan	3,596.986.81€	4,244.444.44€	JO
4.	NP "VICOTRIA INVEST INTERNATIONAL & VICTORIA INVEST SHPK"	Suharekë	3,404.317.00€	4,017.094.06€	JO
5.	"ILEAA –GR"	Prishtinë	4,339.417.40€	5,120.051.53€	JO
6.	"COMPANY BEJTA COMMERCE & BASS COM SHPK & COMPANY MURSELI SHPK"	Gjilan	3,383.742.10€	3,992.815.68€	JO
7.	"LIRIGZONI SHPK & LIRIGZONI - S SHPK"	Skenderaj	2,683.680.68€	3,166.743.20€	JO

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik dhe OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

8.	"SALLAHU" SHPK	Kaçanik	3,278.133.50€	3,868.197.53€	JO
9.	"RSM COMPANY" SHPK	Prishtinë	3,223.885.22€	3,804.184.56€	JO
10.	"ARFA GROUP SHPK & EUROASPHALT" SHPK	Deçan	3,507.885.10€	4,139.304.42€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për ri vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Aferdita Shkoreti– Kryetare e komisionit
- Fatbardh Jakupi– Anëtar i komisionit
- Kukel Ndou – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	"ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION"	Suharekë	3,789.533.30€
2.	"SALLAHU" SHPK	Kaçanik	3,868.197.53€

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhur në përfundim se dy (2) OE, nga gjithsejtë dhjetë (10) pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofruar tender të përgjegjshëm dhe ka rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION" - Suharekë, me çmim në vlerë 3,789.533.30€

Rekomandimi i komisionit është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik dhe OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: **"OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjate 3 viteve të fundit ka qene në vlere, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 5,000,000.00"**, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: **"Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit"**, e operatori ekonomik ankues pretendon se kjo kërkesë nuk është plotësuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", sepse Grupi i OE nuk ka arritur të dëshmojë se qarkullimi i grupit të OE për tri vitet e fundit është 5,000,000.00 €, pasi që në deklaratat tatimore të anëtarit të konzorciumit "Erst Bau" Shpk për tri vite është 1,305,478.13 €, ndërsa anëtari tjetër i konzorciumit "Alba Konstruktion" Shpk ka prezantuar vërtetim nga Drejtoria e përgjithshme e tatimeve si dhe ka bashkangjitur raportin e auditimit të kompanisë, për të cilat është kërkuar deklarata vjetore tatimore e Administratës Tatimore e jo vërtetim dhe pasqyra të raportit të auditimit..

Eksperti shqyrtues sqaron se anëtari i konsorciumit "ERST BAU SHPK", e ka ofruar Formularët e Deklarimeve vjetore dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave për vitet 2016, 2017 dhe 2018 në vlerën siç e ka cekur edhe vet OE ankues, ndërsa anëtari i konsorciumit "ALBA KONSTRUKSION", ka ofruar Konfirmime për vitet 2017, 2018 dhe 2019, të lëshuara nga Ministria e Financave, konkretisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Thatimëve - Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, ku këtyre konfirmimeve ju ka bashkangjitur Pasqyrat Financiare të auditura për vitet 2016, 2017 dhe 2018, e ku të njëjtat janë të vërtetuara nga Noteri z.Driton Hoxha.

Konfirmimet për vitet 2017, 2018 dhe 2019, të lëshuara nga Ministria e Financave, konkretisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Thatimëve - Drejtoria e Tatimpaguesve të Konfirmime për vitet 2017, 2018 dhe 2019, të lëshuara nga Ministria e Financave, konkretisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Thatimëve - Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj nuk kanë vlerë të shënuar, por në to shënon **"Në përgjigje të kërkesave tuaja me nr.20 prot. Datë:06.04.2017, nr.prot 23 datë:05.04.2018 dhe nr. Prot. Datë:27.03.2019, dorëzuar pranë Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, me objekt për njësim pasqyrash financiare vitet 2016, 2017 dhe 2018, ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të konfirmuara të pasqyrave financiare për vitet 2016, 2017 dhe 2018 të deklaruara online nga ana juaj në sistemin tatimor"**.

Këto konfirmime janë të nënshkruara dhe të vulosura nga personat përgjegjës, janë më numër të protokollit NR. 98 e datës:12.04.2017, NR. 528 e datës:10.04.2018 dhe NR. 391 e datës:28.03.2019, mirëpo mendoj se nuk janë konform kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: ***“Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve)”***, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: ***CV e inxhinierit, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Menaxheri duhet të ofroj një deklaratë që nuk është i angazhuar në projekt të MIT (deklaratë e nënshkruar).***

Andaj pas analizimit të dosjes së tenderit eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës me Vendim si menaxher të projektit e ka caktuar z.Genc Xhafa i lindur me 04.01.1974, me përgatitje superiore na Universiteti Politeknik i Tiranës (Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale), e ku si dëshmi i ka bashkangjitur Diplomën kopje, kontratën, CV, Letër Referencën, deklaratën si dhe Vërtetimin e lëshuar nga Noteri në lidhje me Diplomën dhe kontratën e punës, dhe askund nuk është kërkuar ***nostrifikimi i Diplomës*** dhe ky inxhinier është pjesë e anëtarit të konsorciumit ***“ALBA KONSTRUKSION”***, nga Shqipëria..

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: ***“Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik - tri vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar”***, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: ***“CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit”***.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik, i ka ofruar të gjitha dëshmitë e kërkuar, dhe askund nuk është kërkuar të nostrefikohet diploma, si dhe ky inxhinier është pjesë e anëtarit të konsorciumit ***“ALBA KONSTRUKSION”***, nga Shqipëria.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: ***“Lista e kontratave të realizuara përfunduar në lëmin e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 5,000,000.00 euro. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve”***, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: ***“Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëmin e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare”***.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ***“ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION”***, në dosjen e tenderit ka ofruar listat e kontratave, si dhe këtyre listave jua ka bashkangjitur kontratat, referencat dhe procesverbalet. Procesverbalet janë ofruar për projektet ***“Ndërtimi i rrugëve në***

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “SALLAHU” SHPK – Kaçanik dhe OE “RSM COMPANY” SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m”, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

Suharekë, Shirokë, Nishor, Duhle – 4 Lote/pjesë, Lot 1 Ndërtimi i rrugëve “Luigj Nikolla, Avdyl Kuçi, rruga të stadiumi në Suharekë”, me numer të prokurimit 624-17-067-521, AK-Komuna Suharekë, në vlerë 68,584.70€, “Rregullimi i rrugës Brigada 123, Qendër –Suharekë 4 – lote/pjesë, Asfaltimi i Segmenteve Rr. Hasan Prishtina, Xhavit Sylja – Shtres e asfaltit, rrugë dhe segmente tjera”, me numer të prokurimit 624-18-5572-521, AK-Komuna Suharekë, në vlerë 104,315.50€, dhe “Ndërtimi i Rrugëve Lokale 12 Lote/pjesë – Lot 6: Ndërtimi i rrugëve Mehdi Xhaferi, Bashkatdhetarët, Elezajt, Yll Bytyqi, Martirët e Semetishtit në Semetisht”, me numër të prokurimit 624-18-019-521, AK-Komuna Suharekë, në vlerë 26,836.91€, ndërsa të gjitha tjerat janë Referenca. Ndërsa kontratat e anëtarit të konsorciumit “ALBA KONSTRUKSION”, i kanë të bashkangjitura Formularët e vlerësimit, kështu quhen këta formularë të cilët janë të lëshuar nga autoritet kontraktuese në Shqipëri.

Andaj duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku kërkohet **“Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare”**, mendoj se ky kriter nuk është plotësuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION”.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: **“Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 1 për pjesën 1 dhe pjesën 2”**, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: **“Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të projektit me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit. Nëse OE aplikon për dy pjese (lot) atëherë duhet të ofrohen pajisje për dy pjesët sipas listës tek Aneksi 1”**.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës konkretisht anëtari i grupit të OE “Erst Bau” Shpk, në dosjen e tenderit ka prezantuar kontrata mbi huazimin e mjeteve të punës me kompanitë: “Famis Co - HC”, “Eurofamish.A”, “I. Seferi” SHPK, NP “Kolgeci”, “Kushtrim Sopaj”, “Alton Gashi B.I”, “Buli NTSH”, NT “PARIM”, NTSH “URIMI” dhe NTP “Ibrahimi”.

Të gjitha Kontratat e Huazimit e kanë titullin e aktivitetit të prokurimit **“Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m”**, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, dhe të gjitha këto Kontrata të huazimit janë të vërtetuara nga Noteri z. Minir Zekolli.

Ndërsa sa i përket pretendimit se për disa mjete të cilat regjistrohen grupi i OE “ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION”, ka prezantuar faktura jo librezat e regjistrimit siç është kërkuar, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues nuk e ka specifikuar se për cilat pajisje OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar fatura e nuk ka ofruar librezat të regjistrimit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “SALLAHU” SHPK – Kaçanik dhe OE “RSM COMPANY” SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m”, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: ***“OE duhet te jete i licencuar për prodhimin e bazës së asfaltit”*** e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: ***Dëshmitë 8, 9, 10 - Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE të licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar në mes të qiramarrësi dhe qiradhënësit.***

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës konkretisht lideri i konsorciumit “ERST BAU SHPK”, në dosjen e tenderit e ka ofruar Kontratën mbi furnizimin me asfalt të lidhur në mes të “ERST BAU SHPK” dhe “I SEFERI” SHPK, me titull të aktivitetit të prokurimit ***“Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m”***, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, e nënshkruar me dt:02.05.2019, e vërtetuar nga Noter z. Minir Zekolli, si dëshmi kësaj kontrate ju ka bashkangjitur Leja për aktivitete të veçanta, e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në kohëzgjatje deri me 13.04.2019, mirëpo kontratës së noterizuar dhe Lejes si dëshmi shtesë i është bashkangjitur një Njoftim i lëshuar me dt:15.04.2019, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ku në të thuhet: ***Me anë të kësaj shkrese ju njoftojmë se ndërmarrjen “ I. SEFERI” SHPK –Suharekë, me numër të biznesit 70373100, ka aplikuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, për tu licencuar për leje për Aktivitete të Veçanta – Bazë Asfalti me datën 08.04.2019, me numër të aplikacionit 1001, përfaqësuar nga Beqi Sefa.***

Kjo ndërmarrje të gjithë dokumentacionin për licencim e ka të kompletuar dhe do të jetë për shqyrtim në mbledhjen e Bordit që do të mbahet, pra ju informojmë se kompania është në procedurë e sipër për tu licencuar.

Gjithashtu /nga Autoriteti kontraktues si dëshmi shtesë një ditë pas dorëzimit të dosjes së AK-së është ofruar Lejen për aktivitete të veçanta, kopje të noterizuar, kjo Leje është e lëshuar në emër të kompanisë “I SEFERI” SHPK, me dt:05.06.2019, dhe me kohëzgjatje deri me dt:22.12.2023.

Përgjigje në Pretendimi nr. 7

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: ***“OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr”***, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: ***Dëshmitë 8, 9, 10 - Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE të licencuar. Bashkangjitur duhet të jetë Licencat e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar në mes të qiramarrësi dhe qiradhënësit.***

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës konkretisht lideri i konsorciumit “ERST BAU SHPK”, në dosjen e tenderit e ka ofruar Kontratën mbi furnizimin me Gurë të Thyer të lidhur në mes të “ERST BAU SHPK” dhe “FAMIS CO-HC” SH,A, me titull të aktivitetit të prokurimit ***“Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m”***, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, e nënshkruar me

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “SALLAHU” SHPK – Kaçanik dhe OE “RSM COMPANY” SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m”, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

dt:02.05.2019, e vërtetuar nga Noter z. Minir Zekolli, si dëshmi kësaj kontrate ju ka bashkangjitur Leja për aktivitete të veçanta, e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në kohëzgjatje deri me 11.04.2022, Licenca për shfrytëzim Gur i Fortë dhe Licenca për shfrytëzim Gur i Gëlqeror, që te dyat janë të vërtetuara nga Noter z. Minir Zekolli.

Përgjigje në Pretendimi nr. 8

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: ***“OE duhet të jete i licencuar për prodhimin e bazës së betonit”***, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: ***Dëshmitë 8, 9, 10 - Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE të licencuar. Bashkangjitur duhet të jetë Licencat e OE. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar në mes të qiramarrësi dhe qiradhënësit.***

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës konkretisht lideri i konsorciumit “ERST BAU SHPK”, në dosjen e tenderit e ka ofruar Kontratën mbi furnizimin me Beton të lidhur në mes të “ERST BAU SHPK” dhe “FAMIS CO-HC” SH.A, me titull të aktivitetit të prokurimit ***“Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m”***, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, e nënshkruar me dt:02.05.2019, e vërtetuar nga Noter z. Minir Zekolli, si dëshmi kësaj kontrate ju ka bashkangjitur Leja për aktivitete të veçanta, e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në kohëzgjatje deri me 30.06.2021.

Përgjigje në Pretendimi nr. 9

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: ***“OE duhet të ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshirë përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do të realizohet”***, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: ***Dëshmia 11. Originali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe vulosur nga kompania.***

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION”, në dosjen e tenderit e ka ofruar “Propozim Planin për menaxhimin e trafiku, i cili është origjinal i elaboruar në tekst, i vulosur dhe i nënshkruar, si dhe është i bërë në formë grafike. Pra i njëjti është i vulosur nga kompania “ERST BAU”, SHPK, ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, është i nënshkruar, mirëpo nuk është emri i nënshkruesit, por vetëm nënshkrimi.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri vlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: *Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1 për pjesën 1 dhe pjesën 2*, e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: *"Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të projektit me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar në mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Nëse OE aplikon për dy pjese (lot) atëherë duhet te ofrohen pajisje për dy pjesët sipas listës tek Aneksi 1".*

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "RSM COMPANY" SHPK, për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin *"Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m"*, konkretisht për kërkesën me nr 16 të kësaj liste *(Cilindrat me rrota të kombinuara gomë dhe hekur 7-8 t)*, ka ofruar kontrata të shitblerjes të lidhura në mes të "RSM COMPANY" SHPK dhe NTSH "DRINI COMPANY".

Mirëpo kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dëshmi për këto pajisje janë kërkuar fatura ose DUDA, dhe në çoftë se nuk i posedon pajisjet, thotë që Operatori duhet të ofroj marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve, marrëveshja duhet të në emër të projektit , me validitet të kohëzgjatjes së të kësaj kontrate e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët si dhe marrëveshja duhet të jetë e noterizuar.

Autoriteti kontraktues për hir të trajtimit të barabartë ka mundur që konform nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues "RSM COMPANY" SHPK, që të ofroj ndonjë dëshmi shtesë në lidhje me këto pajisje.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se te Lista për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin *"Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m"*, konkretisht në kërkesën me nr 16 të kësaj liste janë kërkuar Cilindrat me rrota të kombinuara gomë dhe hekur 7-8 t, dy copë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", në dosjen e tenderit ka ofruar DUDA Doganor në emër të "EUROFAMIS", Rul për shtrimi e rrugëve e përdorur DV90 VO, viti i prodhimit 2005, numër shasisë H1660082, me peshë bruto 9,400 kg.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se te Lista për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", konkretisht në kërkesën me nr 17 të kësaj liste janë kërkuar Cilindrat me rrota të kombinuara gomë dhe hekur 12 t, dy copë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", në dosjen e tenderit ka ofruar Cilindër Bowil tipi TB10000HA, viti prodhimit 1977, pesha neto 10,850 kg, i marruar me huazim nga NP KOLGECI", dhe Cilinder vibruës "Dynapack", viti i prodhimit 1979, numri serik 3DB002824, pesha 6760 kg, të huazuar NP "KOLGECI".

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Eksperti shqyrtues konstaton se te Lista për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", konkretisht në kërkesën me nr 18 të kësaj liste janë kërkuar Cilindrat me rrota të kombinuara gomë dhe hekur 3 t, dy copë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", në dosjen e tenderit ka ofruar Cilindër "Hamm DV2", tipi 5H1201, viti prodhimit 1989, pesha 2600 kg, i marruar me Kontratë mbi huazim nga NP "KOLGECI", dhe Cilindër "Hamm" tipi HD 10K, viti i prodhimit 1996, numri serik 39643, pesha 2550 kg, i marruar me Kontratë mbi huazim nga "EUROFAMIS" SHA, si dhe Cilindër "Bomag" tipi 100 AD3, numër serik 10115011618, viti i prodhimit 1998, pesha 2470 kg, asnjëri nga këta cilindra nuk e kanë peshën 3 tonë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Eksperti shqyrtues konstaton se te Lista për Pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm për projektin "Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m", konkretisht në kërkesën me nr 19 të kësaj liste janë kërkuar Cisterna (tanket) e ujit 3 copë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "RSM COMPANY" SHPK, ku pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "ERST BAU SHPK & ALBA KONSTRUKSION", në dosjen e tenderit ka ofruar ka paraqitur një fature për cisterne "Majevica 14026" dhe jo Librezën, e ku autocisternat janë makineri qe qarkullojnë në komunikacion dhe patjetër duhet të regjistrohen, eksperti shqyrtues sqaron se me dt:18.09.2019, nga Noteri Minir Zekolli, është përpiluar një Procesverbal mbi Konfirmimin e faktit, në këtë procesverbal ndër pajisjet tjera është e evidentuar Cisterna e ujit "Majevica", e vitit 2001 me faturë 26/2015.

Gjithashtu në kontratën për huazim të lidhur në mes të "ERST BAU SHPK" dhe "FAMIS CO-HC" SHA, tek numrat rendor 24 dhe 25 janë Cisterna Mercedes , tipi 814, nr. Serik G7401115145026, viti 1984, dhe Cisterna FAP, tipi 1213-36, nr. Serik 00036700513004525, viti 1988.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit është kërkuar: **"OE duhet të jete i licencuar për prodhimin e bazës së asfaltit"** e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: **Dëshmitë 8, 9, 10 - Kopja e licencës së vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet të jete Licencat e OE. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar në mes të qiramarrësi dhe qiradhënësit.**

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës konkretisht lideri i konsorciumit "ERST BAU SHPK", në dosjen e tenderit e ka ofruar Kontratën mbi furnizimin me asfalt të lidhur në mes të "ERST BAU SHPK" dhe "I SEFERI" SHPK, me titull të aktivitetit të prokurimit **"Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m"**, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, e nënshkruar me dt:02.05.2019, e vërtetuar nga Noter z. Minir Zekolli, si dëshmi kësaj kontrate ju ka bashkangjitur Leja për aktivitete të veçanta, e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në kohëzgjatje deri me 13.04.2019, mirëpo kontratës së noterizuar dhe Lejes si dëshmi shtesë i është bashkangjitur një Njoftim i lëshuar me dt:15.04.2019, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ku në të thuhet: **Me anë të kësaj shkrese ju njoftojmë se ndërmarrjen " I. SEFERI" SHPK –Suharekë, me numër të biznesit 70373100, ka aplikuar në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, për tu licencuar për leje për Aktivitete të Veçanta – Bazë Asfalti me datën 08.04.2019, me numër të aplikacionit 1001, përfaqësuar nga Beqi Sefa.**

Kjo ndërmarrje të gjithë dokumentacionin për licencim e ka të kompletuar dhe do të jetë për shqyrtim në mbledhjen e Bordit që do të mbahet, pra ju informojmë se kompania është në procedurë e sipër për tu licencuar.

Gjithashtu /nga Autoriteti kontraktues si dëshmi shtesë një ditë pas dorëzimit të dosjes së AK-së është ofruar Lejen për aktivitete të veçanta, kopje të noterizuar, kjo Leje është e lëshuar në emër të kompanisë "I SEFERI" SHPK, me dt:05.06.2019, dhe me kohëzgjatje deri me dt:22.12.2023.

Përgjigje në Pretendimi nr. 7

Eksperti shqyrtues konstaton se njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: **"Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore me se paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve)",** e tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: **CV e inxhinierit, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SALLAHU" SHPK – Kaçanik dhe OE "RSM COMPANY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m"**, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).

e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Menaxheri duhet të ofroj një deklaratë që nuk është i angazhuar në projekt të MIT (deklaratë e nënshkruar).

Pas analizimit të dosjes së tenderit eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës me Vendim si menaxher të projektit e ka caktuar z.Genc Xhafa i lindur me 04.01.1974, me përgatitje superiore na Universiteti Politeknik i Tiranës (Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale), e ku si dëshmi i ka bashkangjitur Diplomën kopje, kontratën, CV, Letër Referencën, deklaratën si dhe Vërtetimin e lëshuar nga Noteri në lidhje me Diplomën dhe kontratën e punës.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se për të njëjtën arsye (Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale), është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit “Zgjerimi i rrugës Nacionale N2 segmenti Hyrja në Qytetin e Prishtinës (Veternik) me nr. prokurimi: MI-19-016-511, Kompania “JOOS KRASNIQI & PEVLAKU”, dhe shihet qartë përdorimi i standarde të dyfishtë gjatë vlerësimit nga AK-së, për kompani të ndryshme, eksperti shqyrtues konstaton se aktiviteti i prokurimit “Zgjerimi i rrugës Nacionale N2 segmenti Hyrja në Qytetin e Prishtinës (Veterrik) me nr. prokurimi: MI-19-016-511, ka të bëjë me aktivitet tjetër të prokurimit .

Gjithashtu eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi në lidhje me Inxhinierin për Ndërtime Civile Industriale, ku Kompania “JOOS KRASNIQI & PEVLAKU”, është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit “Zgjerimi i rrugës Nacionale N2 segmenti Hyrja në Qytetin e Prishtinës (Veternik) me nr. prokurimi: MI-19-016-511, ka qenë pretendim ankimor te kërkesa për shqyrtim e dt: 27.05.2019, pranë AK-së, dhe në Vendimin e dt:30.05.2019, për refuzim nuk është dhënë as një arsyetim apo përgjigje në lidhje me këtë pretendim.

Gjithashtu AK-së në vendimin e dt:30.05.2019, dërguar OE ankues “RSM COMPANY” SHP, e pranon që ka pasur lëshime ku Citon: Gjatë vlerësimit të projektit përkatësisht pajisjeve AK-Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, ka vepruar konform nenit 59 paragrafi 4, përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet aq sa është e mundshme dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri vlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “SALLAHU” SHPK – Kaçanik dhe OE “RSM COMPANY” SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rehabilitimi i rrugës Rajonale R 108, Segmenti II, L=12,580.00m”, me numër të prokurimit: 205-19-1410-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës (MI).